



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 03 Maj 2023

Nr: 432

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 338 ID NGA KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT PËR ZJ. ANITA SHEHU, INSPEKTOR BORXHI NË BASHKINË VLORË, ZJ. KOZETA HALILI SPECIALISTE TURIZMI, DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TURIZMIT NË BASHKINË VLORË, SUBJEKTIN ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË" PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 03 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**SUBJEKT:** Zj. Anita Shehu, Inspektor Borxhi në bashkinë Vlorë  
Zj. Kozeta Halili Specialiste Turizmi, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në bashkinë Vlorë  
Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë"

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

### KONSTATOJ:

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me shkresën nr. 262 prot., datë 14.4.2023, i protokolluar pranë nesh me shkresën nr. 3897 prot., datë 18.4.2023 nga "Komiteti Shqiptar i Helsinkit". Denoncuesi pretendon se janë përdorur burime njerëzore të institucioneve në varësi të bashkisë Vlorë, për qëllime zgjedhore.

Denoncimi është regjistruar me nr.338 ID dhe pretendohet si më poshtë vijon:

*"Më datë 3 Mars 2023, pranë njërit prej subjekteve hoteliere të qytetit, është zhvilluar një aktivitet me temë "Gruaja në sipërmarrje, rruga drejt furnizimit të sipërmarrjes dhe roli i grave në këtë proces", nga Partia Socialiste, dega Vlorë. Në përputhje me agjendën e ndarë aktiviteti është mbajtur në orën 12:00, ndërkohë që pjesëmarrësit në të përfaqësojnë punonjës të institucioneve vendore në varësi të bashkisë, përkatësisht nga Drejtoria e Tatimeve, Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor, etj".*

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Në vijim të procedurës administrative, fillova hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtarinë publike, për të cilën ekzistojnë dyshime të arsishme se janë kryer në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Më datë 20.4.2023, bashkisë Vlorë i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike ku i kemi kërkuar identifikimin e punonjësve të përfshirë në aktivitetin e denoncuar.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë administruar kthimi i pergjigjeve nga dy punonjëse.

Më datë 26.4.2023, zj. Anita Shehu, me detyrë Inspektor Borxhi në bashkinë Vlorë, bën me dije se: "Aktiviteti në të cilin unë kam marrë pjesë, ka qenë një aktivitet me rastin e festës së 8

*marsit festa ndërkombëtare e nënës dhe gruas dhe nuk ka lidhje me ndikimin tim si person në fushatë zgjedhore. Si grua dhe nënë e këtij qyteti kam marrë pjesë e ftuar në këtë aktivitet, aktivitet i cili zgjati jo më shumë se 1 orë dhe nuk ka ndikuar në punën që unë kryej si inspektore borxhi në bashkinë Vlorë”.*

Më datë 26.4.2023, zj. Kozeta Halili, me detyrë Specialiste Turizmi, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në bashkinë Vlorë bën me dije se: *“Në lidhje me aktivitetin e zhvilluar më 3 Mars me temë: “Gruaja në sipërmarrje, rruga drejt furnizimit të sipërmarrjes dhe roli i grave në këtë proces”, po ju sqaroj se: Jam një artizane e vjetër e qytetit të Vlorës (me titullin Mjeshtër të marrë nga Dhoma Kombëtare e Zejeve) Këtë rrugetim, këtë eksperiencë ndër vite e ndava në këtë aktivitet, për t’u treguar grave të tjera se janë forcë e madhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Aktiviteti u organizua në kuadër të festave të 7- 8 Marsit. Prezenca ime në këtë aktivitet ishte për të përcjell vlerat e mia si grua artizane dhe ska lidhje apo nuanca politike të asnjë lloji. Nuk mendoj që kam bërë shkelje të Kodit Zgjedhor, pasi e ritheksoj pjesëmarrja ime ishte si gruaja artizane në qytetin e Vlorës”.*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur.

Të pranishëm në këtë seancë ishte përfaqësuesi i Komitetit Shqiptar të Helsinkit i cili ju qëndroi pretendimeve të tij, të paraqitura shkresërisht nëpërmjet denoncimit.

Në seancën publike të zhvilluar, nuk pati përfaqësues të bashkisë Vlorë.

Në përfundim të hetimit administrativ, u identifikuan dy prej punonjësve të cilët janë punonjës në bashkinë Vlorë.

Nëpërmjet provave të administruara foto u provua se veprimtaria publike është zhvilluar në ambjentete private, konkretisht në hotel “Regina City Lungomare”.

U administrua ftesa e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila sikurse pretendohet nga denoncuesi ju është dërguar *punonjësve të institucioneve vendore në varësi të bashkisë Vlorë*, për të marrë pjesë në takimin, e datës 03 Mars 2023.

Referuar nenit 91, pika 2, të Kodit Zgjedhor *“Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.*

Kjo dispozitë kërkon “përdorimin e detyruar brenda orarit të punës” dhe “për qëllime zgjedhore”.

Në mënyrë që të provohet shkelja administrative, nga ana e punonjësve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet, duhet të vërtetohet qëllimi zgjedhor i aktivitetit. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mundet të vlerësojë këta elemente si të ndarë nga njëri tjetri nga “qëllimi zgjedhor”, pasi do e nxirrte atë jashtë kompetencës së tij lëndore. **Fakti që aktiviteti është organizuar nga një parti politike, e cila në momentin e zhvillimit të aktivitetit qenë ende e regjistruar për zgjedhjet për organet vendore të 14 Majit 2023 dhe nuk ka pasur as kandidatë për kryetarë bashkie apo këshilli bashkiak, nuk provon kushtin e “qëllimit zgjedhor”.**

Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator në nenin 6, pika 3 të tij e qartëson edhe me tej nenin 91, pika 2, të Kodit Zgjedhor. Neni parashikon se “*Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdolloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje.*”

Pjesëmarrja e punonjësve duhet të jetë për të mbështetur një forcë politike, subjekt zgjedhor apo kandidat në zgjedhje, në mënyrë që të ketë përfitime zgjedhore. “Partia Socialiste e Shqipërisë” është regjistruar si subjekt zgjedhor me vendimin nr. 153 datë 09.03.2023, “Për shqyrtimin e kërkesës së PS”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e këtij subjekti lindin pas regjistrimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Përsa më sipër, bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ zj. Anita Shehu, me detyrë Inspektor Borxhi në bashkinë Vlorë, zj. Kozeta Halili, me detyrë Specialiste Turizmi, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në bashkinë Vlorë dhe subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë, pasi objekti i këtij vendimi nuk përbën shkelje të pikës 2, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 6, pika 3, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

#### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91 dhe të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Data: 05 Maj 2023    Nr: 432  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit”

## V E N D O S:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative dhe pushimin e hetimit administrativ ndaj zj. Anita Shehu, zj. Kozeta Halili dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**